

**SHTOJCA 2**

**RELACIONI I PROGRAMIT BUXHETOR  
AFATMESEM VENDOR I RISHIKUAR 2020 -2022**

**Përgatitur gusht 2019**

# Programi Buxhetor Afatmesëm Vendor i rishikuar 2020-2022

## Bashkia Korçë

### Tabela e lëndës

1. Vështrim i përgjithshëm.....	4
Situata e njësisë së vetëqeverisjes vendore.....	4
Çështje kryesore për projektet dhe politikat e bashkisë.....	4
Informacion financiar kryesor.....	5
2. Orientimi afatgjatë i bashkisë.....	5
Bujqësia.....	8
Turizmi.....	8
Industria.....	8
Sfidat kryesore të zhvillimit.....	12
Paraqitja e projekteve kryesore–arsyet dhe përfituesit.....	13
Plani i shpenzimeve kapitale /projekt plani 2020-2022.....	13
3. Informacion financiar.....	15
Supozimet e planifikimit.....	15
Burimi i të ardhurave.....	16
Shpenzimet.....	20
Informacion financiar suplementar.....	23
4. Monitorimi i zbatimit të strategjisë së Zhvillimit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.....	27
Hyrje–rezultati i përgjithshëm dhe përfundime.....	27
Lista e masave strategjike për çdo fushë prioritare – statusi i zbatimit.....	28
5. Informacion për programet Buxhetore.....	28
<b>FUNKSIONI 1: SHËRBIME TË PËRGJITHSHME PUBLIKE.....</b>	<b>28</b>
5.1. Nënfunksioni 011: Organet ekzekutive dhe legjislative, çështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme.....	28
<b>FUNKSIONI 2: SHËRBIME TË HUAMARRJES VENDORE.....</b>	<b>30</b>
5.2. Nënfunksioni 017: Shërbime të huamarrjes vendore.....	30
<b>FUNKSIONI 3: RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE.....</b>	<b>31</b>
5.3. Nënfunksioni 031: Shërbimet policore.....	31
5.4. Nënfunksioni 032: Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri.....	32
<b>FUNKSIONI 4: ÇËSHTJE EKONOMIKE.....</b>	<b>33</b>
5.5. Nënfunksioni 041: Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës.....	33
5.6. Nënfunksioni 042: Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia.....	34
5.7. Nënfunksioni 045: Transporti.....	35
5.8. Nënfunksioni 047: Industri të tjera.....	37
<b>FUNKSIONI 5: MBROJTJA E MJEDISIT.....</b>	<b>38</b>

5.9.	<i>Nënfunksioni 051: Menaxhimi i mbetjeve</i>	38
5.10.	<i>Nënfunksioni 056: Mbrojtja e mjedisit</i>	38
	<b>FUNKSIONI 6: STREHIMI DHE KOMODITETET E KOMUNITETIT</b>	39
5.11.	<i>Nënfunksioni 061: Urbanistika</i>	39
5.12.	<i>Nënfunksioni 062: Zhvillimi i komunitetit</i>	40
5.13.	<i>Nënfunksioni 064: Ndriçimi i rrugëve</i>	41
	<b>FUNKSIONI 8: ARGËTIMI, KULTURA DHE FEJA</b>	42
5.14.	<i>Nënfunksioni 081: Shërbimet rekreative dhe sportive</i>	42
5.15.	<i>Nënfunksioni 082: Shërbime kulturore</i>	43
	<b>FUNKSIONI 9: ARSIMI</b>	44
5.16.	<i>Nënfunksioni 091: Arsimiti parashkollor dhe bazë</i>	44
5.17.	<i>Nënfunksioni 092: Arsimiti parauniversitar</i>	45
	<b>FUNKSIONI 10: MBROJTJA SOCIALE</b>	46
5.18.	<i>Nënfunksioni 101: Sëmundje dhe paaftësi</i>	46
5.19.	<i>Nënfunksioni 102: Të moshuarit</i>	47
5.20.	<i>Nënfunksioni 104: Familja dhe fëmijët</i>	48
5.21.	<i>Nënfunksioni 106: Strehimi Social</i>	49

# **1. Vështrim i përgjithshëm**

## **Situata e njësisë së vetëqeverisjes vendore**

Korça është një qendër kryesore urbane e pjesës juglindore të Shqipërisë përse i përket madhësisë, popullsisë, administrimit, aktiviteteve ekonomike dhe kulturore. Qyteti është vendi ku ofrohet një numër i madh shërbimesh, aktiviteteve dhe lehtësirash që janë të lidhura jo vetëm me qytetin, por edhe me pjesë të tjera të rajonit. Këtu përfshihen: shërbimet publike dhe administrative (Universitet, Spitali Rajonal, Gjykata e Apelit, Zyrat e Qarkut, Zyrat e Shërbimeve Publike, etj), aktivitetet ekonomike (aktivitete industriale dhe të shitjes me shumicë, pazari, bankat, aktivitete biznesi të mesme dhe të vogla); institucione kulturore (si: teatri, muzeume, libraritë, etj); disa aktivitete dhe ekspozita rajonale (karnavalet, festivali i birrës, etj). Roli thelbësor i Korçës në zhvillimin rajonal bazohet në tri kolona kryesore: (1) si një qendër e zhvillimit ekonomik rajonal, (2) si një qendër e zhvillimit të turizmit, dhe (3) si një qendër administrative dhe arsimimi.

### **Çështje kryesore për projektet dhe politikat e bashkisë**

Plani i Përgjithshëm Vendor 2016-2031 ka përcaktuar çështjet dhe drejtimit kryesore të zhvillimit të synuar për 12 vitet e ardhshme të Bashkisë Korçë:

1. të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore,
2. të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillim të territorit, në bazë të balancimit të burimeve natyrore, të nevojave ekonomike e njerëzore dhe interesave publike e private,
3. të nxisë veprimet e duhura për mbrojtjen, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashëgimisë natyrore e kulturore dhe për ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike dhe të peizazhit,
4. të mundësojë të drejtën e përdorimit e të zhvillimit të pronës, në përputhje me interesat e shoqërisë, instrumentet planifikuese dhe legjislativonin,
5. të krijojë kushte të përshtatshme e të drejta dhe shanse të barabarta për banim, veprimtari ekonomike e sociale për të gjitha kategoritë sociale, kohezion ekonomik e social dhe gëzim të të drejtave të pronësisë.

## Informacion financiar kryesor

Burimi i informacionit: Nxjerrë nga Instrumentii i Planifikimit Financiar

### (F13) STATISTIKA FINANCIARE TË PËRGJITHSHME

	2017	2018	2019	2020	2021	2022
<b>TOTALI I BURIMEVE TË BUXHETIT</b>						
Burimet e përgjithshme të buxhetit	3,722,077	2,819,303	2,798,389	2,405,117	2,464,699	2,522,960
<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>						
Shpenzimet e përgjithshme	3,188,297	2,457,610	2,798,389	2,401,428	2,460,890	2,519,035
<b>TOTALI I FONDEVE REZERVE + KONTIGJENCË</b>						
TOTALI I FONDEVE REZERVE + KONTIGJENCË				3,689	3,808	3,925
<b>FITIMI / HUMBJA E PËRGJITHSHME</b>						
Përfitimi (+)/ Humbja (-) e përgjithshme	533,780	361,693	-	1	1	0
	OK!	OK!	OK!	OK!	OK!	OK!

## 2. Orientimi afatgjatë i bashkisë

Orientimi afatgjatë i Bashkisë përcaktohet nga vizioni për zhvillimin e saj.

....Në vitin 2030.....

Korça e kulturës, historisë, dizajnit urban dhe natyrës, një Bashki që ngjall krenarinë, zgjon pasionin dhe ndjenjën e përkatësisë për të gjithë banorët e saj.

Qendër rajonale me rëndësi kombëtare, me një ekonomi konkurruese, sipërmarrje dinamike, bujqësi e turizëm të zhvilluar, e fokusuar tek inovacioni duke u kujdesur në mënyrë të veçantë për mjedisin.

### KORÇA JONË - E TË GJITHËVE!

Gjatë këtyre viteve, përmes instrumenteve të planifikimit në përputhje me këtë dokument të strategjisë, Bashkia Korçë synon ta ndërtojë të ardhmen e saj mbi kulturën historike, shoqërore dhe natyrore që ka arritur të trashëgojë prej shekujsh. Këto trashëgimi, i kanë shërbyer dhe do vazhdojnë t'i shërbejnë Korçës si gurë themeli për ruajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të hapësirave urbane dhe rurale gjithëpërfshirëse, të cilat zgjojnë ndjenjën e përkatësisë të hapësirave urbane, të të gjithë banorëve të bashkisë. Prioriteti kryesor i Bashkisë Korçë është mirëqenia e qytetarëve të saj, të cilën synon që ta mbështesë përmes zhvillimit ekonomik, promovimit e mbështetjes së marrëdhënieve ndërkufitare, mbrojtjes së mjedisit, përmirësimit të infrastrukturës dhe gjithëpërfshirjes sociale.

Korça po forcohet ndjeshëm e do të vazhdojë të jetë një qendër e një poli rajonal me rëndësi kombëtare, e cila në mënyrë të qendrueshme do të fuqizojë asetet turistike, bujqësore dhe natyrore që disponon.

Duke qenë të ndërgjegjshëm për potencialin e këtij territori dhe banorëve të saj, si dhe të përkushtimit

dhe punës prej brezash për ta pasuruar atë, synimi kryesor i joni është që me fuqitë tona aktuale të ndërtojmë një territor akoma më të frytshëm, akoma më të shëndetshëm, akoma më ftues dhe mbështetës për t’u trashëguar përmes brezave që do të vijnë.

Nën këtë vizion, bazuar te gjetjet e analizës dhe te parimet e qeverisjes vendore, puna e bashkisë për zhvillimin e territorit gjatë këtyre 15-viteve, do të orientohet në tre drejtime kryesore të zhvillimit: bujqësia, turizmi dhe industria.

## **Parimet e Planit Strategjik**

### **Integrimi**

Bashkia Korçë është tashmë një realitet kompleks mjedisesh urbane, me qytetin e Korçës dhe 7 njësi administrative me profil rural. Objektivat e planit strategjik marrin parasysh **ndërlidhjet e ekosistemeve të ndryshme dhe shqyrtohen dhe vleresohen nga ndikimi** që ato kanë tek këto ekosisteme.

### **Qëndrueshmëria**

Vizioni, objektivat dhe programet strategjike synojnë **një habitat të shëndetshëm mjedisor, social dhe ekonomik për popullsinë aktuale pa kompromentuar mundësinë e gjeneratave të ardhshme të plotësojnë nevojat e tyre dhe të progresojnë.**

### **Jetueshmëria**

Jetueshmëria është shuma e faktoreve që përkufizojnë standartin e jetesës së një komuniteti – përfshirë mjedisin urban, natyror, zhvillimin ekonomik, stabilitetin social, mundësinë e arsimit, të kujdesit shëndetësor si dhe mundësitë kulturore dhe të argëtimit. Plani strategjik i Bashkisë Korçë synon rritjen e cilësisë së jetesës për banorët e vet duke konsideruar faktorët e mëposhtëm:

**Hapësirat publike, Formën urbane, Zhvillimin ekonomik, Aksesin në shërbime, Kujdesi social, Mjedisi natyror, Pjesëmarrja e publikut në Qeverisje.**

### **Inovacioni**

Një qasje ndaj planifikimit që inkurajon dhe mundëson përmirësime dhe adoptime të teknikave, teknologjive, produkteve dhe mënyrave të reja për të pasur rezultate sa më të mira. Inovacioni është parim i rëndësishëm që synon të tejkalojë edhe kufizimet financiare me të cilat mund të përballet Bashkia për të realizuar programet dhe projektet e dëshiruara. Plani Strategjik i Korçës synon të adoptojë elementë të “Smart City” (TBD)

## Ruajtja dhe zhvillimi i traditës

Bashkia e Korçës është krenare për pasurinë e trashëgimisë historike urbane. **Zhvillimi i territorit të Bashkisë** do të bëhet duke vlerësuar e mbrojtur trashëgiminë historike urbane të lagjeve, ndërtimet karakteristike, elementët ndërtimor dhe materialet lokale si element i rëndësishëm i pejsazhit urban.

Analiza e gjendjes ekzistuese është baza kryesore për hartimin e Vizionit, i cili më vete është përmbledhja më e përgjithshme konçize e të gjitha propozimeve që lidhen me drejtimet e zhvillimit, objektivat strategjike, e të tjerat me radhë. Me këtë, **NUK duhet të kuptohet se Plani i tij i Veprimit shteron mundësinë e propozimit ose zhvillimit të projekteve, programeve apo objektivave të reja shtesë** për realizimin e Vizionit. Përkundrazi, plani është i nevojshëm që të plotësohet sipas nevojave konkrete të cilat mund të emergojnë jashtë parashikimeve të tij. Në procesin e planifikimit, emergjencat e paparashikuara duhet të konstatohen, rivlerësohen në lidhje me planin, të bëhen rregullimet e nevojshme sipas udhëzimeve ligjore të planifikimit nëse është nevoja, dhe të implementohen masat e nevojshme që duhen marrë.

Dokumenti i PPV-së duhet të kuptohet si një mjet **orientues, jo garantues i zhvillimit**, i cili ndihmon organet e qeverisjes vendore për t'u përqafuar me nevojat lokale për zhvillim dhe për të orientuar potencialet investuese vendore përmes një platforme të përbashkët me qytetarët, që është vetë dokumenti dhe instrumentet që dalin në funksion të tij. Ndërkohë, për aplikimin e efektshëm të propozimeve të planit në territor, është i domosdoshëm **verifikimi konkret i të dhënave të detyrueshme ligjore dhe të planit, me qëllim afrimin e tyre me gjendjen ekzistuese në vend, si dhe konsultim të vazhdueshëm mes grupeve që preken përpara çdo vendim-marrjeje.**

Këto drejtime janë orientuese për të gjitha fazat e mëtejshme të planit. Drejtimet përcaktojnë bazën në të cilën do të orientohet formulimi i politikave urbane, lidhja e objektivave me programet, prioritarizimi i projekteve të zhvillimit, e të tjera. Mirëpo drejtimet e zhvillimit janë specifike në fushën që mbulojnë.

Për të patur një qasje sa më gjithpërfshirëse në organizimin e nevojave për ndërhyrje, dhe në të njëjtën kohë për t'i administruar sa më mirë me drejtimet kryesore të zhvillimit, është shfrytëzuar koncepti i "dimensionit urban". Dimensionet urbane janë përcaktuar në formën e sferave të planifikimi urban, dhe janë përzgjedhur 5 të menduara si më përfaqësueset për njësinë vendore. Kjo është bërë me qëllim për të ndihmuar në kategorizimin e mundësive dhe problematikave të territorit, që jo domosdoshmërisht trajtohen direkt nga drejtimet e zhvillimit. Në këtë mënyrë është e mundur të përcaktohen disa drejtime kryesore zhvillimi për bashkinë, pa lënë në harresë problematikave ose mundësitë e tjera që ofron njësi vendore përtej këtyre drejtimeve.

Zhvillimi i territorit të bashkisë Korçë do të kalojë përmes këtyre pesë dimensioneve të mëposhtme të zhvillimit, të cilat në bashkëpunim me drejtimit e zhvillimit do të mundësojnë udhëheqjen dhe monitorimin e përparimit të objektivave strategjike të zhvillimit, programeve dhe projekteve të zhvillimit. Dimensionet e përzgjedhura për Bashkinë e Korçës janë si më poshtë:

- **Forma urbane**
- **Infrastruktura**
- **Jetesa në komunitet**
- **Strategjia e zhvillimit afatgjatë/strategjia personeli**
- **Drejtimit e përzgjedhura të zhvillimit për Bashkinë Korçë janë:**

**Bujqësia**  
**Turizmi**  
**Industria**



Këto drejtime zhvillimi do të jenë tre shtyllat kryesore orientuese për procesin e zhvillimit të territorit për 15 vitet e këtij plani.

Përsa i përket **zhvillimit të Bujqësisë, një sistem i mirë i administrimit të tokave bujqësore është parësor.**

Strategjia duhet të fokusohet në shërbimin e nevojshëm me infrastrukturë kulluese dhe vaditese, sidomos në fshatrat fushore të Bashkisë, në Njësitë Bulgarec, Voskop dhe Mollaj. Konsiderohet me rëndësi identifikimi i produkteve të vendit dhe mbështetja e tyre sipas zonave ku këto produkte janë më të përshtatshme për t'u kultivuar. Po ashtu, në kuadër të rritjes së kapaciteteve prodhuese dhe tregtuese është e nevojshme që të përllogaritet nevoja për magazinimin në përputhje me kapacitetet prodhuese të bashkisë, për të siguruar një shfrytëzim më eficient dhe strategjik të prodhimit bujqësor vendor. Nuk



duhet të harrojmë që kapaciteti ekzistues prodhues i tokave bujqësore në bashkinë e Korçës, mund të mbulojë të gjitha nevojat vendore për ushqim dhe një pjesë të madhe të nevojave rajonale ose kombëtare. Si fillim, mund të ngrihen kapacitete magazinuese në disa pika kryesore strategjike për këtë synim, si: një në Bulgarec që të shërbejë për grumbullimin e produkteve të prodhuar në pjesën veriore të bashkisë, një në Voskop që do të mbulojë prodhimet në pjesën perëndimore dhe një tjetër në Mollaj që synon t'i shërbejë produkteve bujqësore të prodhuara në pjesën jugore të bashkisë.

Një prej pikave të dobëta në lidhje me shfrytëzimin e tokës bujqësore është paraqitur copëzimi i ngastrave të tokës mes pronarësh të ndryshëm, në sipërfaqe të pashfrytëzueshme më vete ose të pa lidhura/koordinuara me parcelat fqinje. Për këtë arsye, është e nevojshme rritja e angazhimit të fermerëve në forma të ndryshme, në mënyrë që toka të mos humbet, prodhimi të rritet dhe fermerët të mund të fitojnë nga toka e tyre.

Për sa i përket **sektorit të turizmit**, në rastin e Bashkisë Korçë kemi të bëjmë me shumë zona të cilat janë të njohura prej shumë kohësh për traditat e veçanta dhe karakterin e tyre mikpritës. Territori i bashkisë ka trashëguar shumë pasuri të cilat ndryshojnë që nga më natyroret (gjeomonumentet, peisazhet, shtigjet natyrore, biodiversitetin) e deri te më artificialet (banesat, zonat historike, kulturat bujqësore, prodhimet artizanale, kultura shoqërore). Këto pasuri gjenden të shpërndara në sasi të ndryshme sipas zonave që ndodhen, gati në çdo drejtim që mund të merret në territorin e bashkisë. Një ndër detyrat më të rëndësishme të këtij 15-vjeçari është inventarizimi dhe rivlerësimi i pasurive të akumuluar, si dhe marrja e masave për mbrojtjen dhe shfrytëzimin e tyre në gjendje të ruajtshme edhe në të ardhmen. Hartimi i itinerareve turistike, të cilat ndërthurin trashëgimitë kulturore, me ato historike e natyrore do të përbëjnë një hap të dytë zhvillimi në këtë drejtim, duke e konsideruar atë si një mjet që të ndihmojë pjesërisht ose plotësisht për mirëmbajtjen e zonave dhe objekteve monument. Për realizimin e këtyre itinerareve do të jetë e nevojshme një ndërthurje e programeve të turizmit me planet për përmirësimin e shërbimeve publike dhe transportin në veçanti. Përgjatë itinerareve të identifikuara, mund të bëhen ndërhyrje me infrastrukturë mbështetëse për të përmirësuar eksperiencën e vizituesit përsa i përket cilësisë së vizitës, me sinjalistikë turistike, janë masat konservuese që duhet të ndërmarrë bashkia për sa i përket mbrojtjes së monumenteve të kulturës dhe mjedisit. Në këtë kuadër është shumë e rëndësishme që përmes mjeteve të komunikimit të informacionit që shfrytëzon bashkia, të bashkëpunojë me institucionet qendrore e rajonale në misionin e tyre për të ruajtur dhe promovuar zhvillimin e këtyre. Përveç monumenteve këtu duhet të përfshihen edhe sipërfaqet që kanë vlera të veçanta ekologjike apo që janë pjesë e rrjeteve ekologjike. Korça ka në brendësi të territorit të vet dy zona potenciale për integrimin e tyre në rrjetet ndërkombëtare. Në lindje të bashkisë shtrihet një zonë potenciale prej 8'133 ha për rrjetin Emerald, i cili është një rrjet zonash të mbrojtura që synojnë ruajtjen e florës dhe faunës së egër në habitatin e tyre natyror brenda Europës. Në këtë zonë përfshihet edhe

parku kombëtar i “Bredhit të Drenovës”, rreth 1,337 ha, i cili përbën aktualisht të vetmen zonë të mbrojtur nga i gjithë potenciali që ekziston. Përveçse në rrjetin Emerald, në perëndim të bashkisë shtrihet një zonë akoma më e madhe, rreth 36,727 ha, potencial për përfshirjen në rrjetin e mbrojtjes Natyra 2000. Ky është një tjetër rrjet që synon mbrojtjen e habitatit dhe biodiversitetit në Europë, duke përfshirë site tokësore dhe ujore. Në këtë zonë potenciale nuk ka asnjë zonë të mbrojtur. Është e domosdoshme që këto habitate të vazhdojnë të ekzistojnë edhe në të ardhmen. Deri kur të plotësohen kushtet mbrojtëse për integrimin e plotë të këtyre zonave në rrjete të mbrojtura, bashkia duhet të tregohet e kujdesshme që të mos lejojë ndërhyrje urbane përtej atyre ekzistuese në këto zona të egra natyrore, gjithnjë e më të rralla në planetin tonë.

Shtylla e tretë kryesore për zhvillimin e Bashkisë për këto 15 vite do të jetë **sektori i industrisë**. Dikur, territori i bashkisë ka patur një shfrytëzim shumë më të lartë të potencialit të vet industrial (prodhim energjie, industri e rëndë nxjerrëse e përpunuese, etj.) që ishte shumë i lidhur me zhvillimin në nivel kombëtar. Duke qenë se drejtimi i zhvillimit ka ndryshuar, shumica e infrastrukturës së vjetër industriale është amortizuar, dëmtuar ose tjetërsuar sakaq. Megjithatë, industria ofron shumë alternativa akoma sot e kësaj dite, veçanërisht nëse fokusohemi te ajo e lehta. Ndër variantet e kësaj të fundit, është mundësia e zhvillimit të industrisë ushqimore dhe të agro-përpunimit. Kjo mund të krijojë një lidhje komplementare me shumë aspekte të zhvillimit bujqësor dhe ekonomik të vendit. Më tej akoma, bazuar te nënproduktet e saj që teprojnë, kjo industri mund të lidhet lehtë me atë të prodhimit të energjisë alternative për disa forma të ulëta shfrytëzimi, si p.sh: ndriçimi i hapësirave të caktuara publike. Përveç tyre, është e mundur gjithashtu që në zona të caktuara të zhvillohet më tej akoma industria e konfeksioneve, që gjithashtu mund të shihet e lidhur ngushtë me prodhimin vendor. Sektor tjetër i industrisë që mund të zhvillohen është ai i riciklimit të tipeve të caktuara të mbetjeve. Natyrshëm, duke qenë se bashkia ka shumë burime natyrore të cilat mund të shfrytëzohen për aktivitete industriale, është e rëndësishme që ndërhyrjet të marrin parasysh mbrojtjen e mjedisit.

Objektivat strategjike kryesore të Bashkisë Korçë janë:

### **Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik**

Rajoni Bashkia Korçë është qendra juglindore ekonomike e Shqipërisë. Si rrjedhojë do të vazhdojë të mbetet motorri ekonomik i vendit dhe të kthehet në një rajon konkures në Ballkanin Perëndimor. Qendër rajonale me një ekonomi konkures, sipermarrje dinamike, bujqësi të zhvilluar, turizëm shumëdimensional, e fokusuar tek inovacioni dhe duke u kujdesur në mënyrë të veçantë për mjedisin.

1. Zhvillimi i potencialit bashkiak për krijimin e një klime atraktive për tërheqjen e investimeve vendase dhe të huaja në Korçë, si dhe bashkëpunimi ndër-kufitar me qëllim zhvillimin e biznesit dhe rritjen e mundësive për punësim.

2. Ngritja dhe fuqizimi i një rrjeti të mbështetjes institucionale dhe infrastrukturore për zhvillimin e Bujqësisë në Bashkinë e Korçës si një motor i zhvillimit ekonomik të zonës në tërësi
3. Transformimi i Korçës në një destinacion turistik me shumë dimensione si: i) kulturore, ii) natyrore (eko-turizëm), iii) të shijes, etj.
4. Rivitalizimi i sektoreve të Industrisë.

### **Përmirësimi i Cilësisë Urbane/ Rurale**

Duke parë përqëndrimin e lartë të zonave urbane në rajon ky objektivi synon përmirësimin e cilësisë së mjedisit të ndërtuar në hapësirën administrative të Bashkisë Korçë. Zhvillimi kaotik i dekadave të fundit i lidhur dhe me zhvillime informale ofron një pasqyrë të vështirë urbane. Si rrjedhojë, duke parë dhe dëshirën për tërheqjen e talenteve dhe kompanive të huaja, përtej atyre vendase, është e udhës që cilësia urbane të kthehet në një prioritet për këtë plan. Përmirësimi i këtij mjedisi me anë të projekteve të rigjenerimit, konsolidimit si dhe integritit do të ofrojë një mundësi të mirë për ofrimin e modeleve të zhvillimit të qëndrueshëm të komuniteteve, do të rrisë atraksionin e këtij rajoni edhe në nivel ndërkombëtar, si dhe do të nxisë industrinë e ndërtimit të kontrolluar ekologjikisht dhe të turizmit, të cilat janë në një nivel jo të kënaqshëm për momentin. Duke përmirësuar proceset planifikuese dhe manaxhuese, Korça do të ketë një formë urbane që i përshatet objektivave ambicioze të bashkisë dhe mbështesë zhvillimin në tërësi.

### **Përmirësimi i Infrastrukturës së Transportit dhe Mobilitetit në Rajon**

Zhvillimi i mobilitetit dhe optimizimi i lëvizshmërisë midis zonave të kësaj hapësire me qëllim përmirësimin e ndërlidhjes midis bizneseve dhe furnitorëve të tyre, si dhe aksesin e individëve tek shërbimet e ofruara nga kjo hapësirë ekonomike. Master plani i transportit duhet të marrë parasysh zhvillimin e rrugëve, transportin publik dhe parkimin, si dhe të sigurojë më shumë lidhje ndërmjet lagjeve; të rrisë aksesueshmërinë nga të gjithë. Për më tepër, duhet të nxisë modelet alternative të transportit dhe të theksojë nocione specifike për transportin publik. Plani ka propozuar zhvillimin e një sistemi rrugësh këmbësorësh dhe biçikletash që duhet të përdorin topografinë e sheshtë të qytetit dhe traditën urbane të përdorimit të biçikletave. Rrjetet e këmbësorëve dhe të biçikletave synojnë të çojnë në ulje të varësisë nga makinat dhe në ulje të nivelit të ndotjes, e nga ana tjetër të sjellin një ndikim shumë pozitiv mbi shëndetin dhe cilësinë e jetës publike. Infrastrukturë publike që rrit mundësinë e zhvillimit të bizneseve dhe komuniteteve, duke u shoqëruar me rritjen e mobilitetit për qarkullimin e njerëzve dhe mallrave në mënyrë të “zgjuar” dhe efëcente.

### **Mbrojtja dhe Përmirësimi i Cilësisë së Mjedisit Natyror**

Ruajtja e Burimeve Natyrore dhe Mbrojtja e Mjedisit, ku konsiderohet Uji si prioritet i zhvillimit, përmirësimi i kualitetit dhe i sigurisë së aksesit me ujërat liqenore e sipërfaqësore, përdorimi teknologjive me zero emetim të dëmshëm. Integrimi i sistemeve natyrore me dizajnin e infrastrukturës

si dhe krijimi i rrjeteve të parqeve nga niveli lokal tek ai rajonal. Mjedis natyror i mbrojtur duke implementuar standartet teknike e ligjore për trajtimin e ekosistemeve dhe ruajtjen e biodiversitetit, duke siguruar kushtet e nevojshme për zhvillimin urban.

#### **Sfidat kryesore të zhvillimit**

Bazuar në Vizionin dhe në politikat e zhvillimit të Bashkisë Korçë PPV-ja 2016-2031 ka përcaktuar çështjet kryesore dhe projektet sipas objektivave strategjike për 5 vitet e para të implementimit të Planit.

Objektivat janë ndarë duke evidentuar rast pas rasti edhe mundësitë e zhvillimit që ofrohen për tre drejtimet kryesore të zhvillimit.

#### **▪ Infrastruktura**

**Synimi :** Infrastruktura publike që rrit mundësinë e zhvillimit të komunitetit dhe ekonomisë vendore, duke u mbështetur te sigurimi i mobilitetit për qarkullimin e njerëzve dhe mallrave në mënyrë të “zgjuar” dhe efiçente.

**Objektivi:** Përmirësim i rrjetit rrugor të Bashkisë dhe shërbimeve të transportit

Për përmbushjen e këtij objektivi është parashikuar programi rrjeti rrugor.

**Objektivi:** Përmirësim i shërbimeve të Transportit

Për përmbushjen e këtij objektivi është parashikuar programi i zhvillimit të transportit publik.

#### **▪ Zhvillimi ekonomik dhe Inovacioni**

**Synimi:** Qendër rajonale me një ekonomi konkurruese, sipërmarrje dinamike, bujqësi të zhvilluar, turizëm shumë-përmasor, të fokusuar tek inovacioni dhe duke u kujdesur në mënyrë të veçantë për mos-dëmtimin e mjedisit.

**Objektivi:** Zhvillimi i potencialit bashkiak për krijimin e një klime tërheqëse për investimet vendase dhe të huaja në Korçë, duke promovuar e mbështetur bashkëpunimin ndër-kufitar me qëllim zhvillimin e biznesit dhe rritjen e mundësive për punësim.

**Objektivi :** Ngritja dhe fuqizimi i një rrjeti të mbështetjes institucionale dhe infrastrukture për zhvillimin e Bujqësisë në Bashkinë e Korçës si një motor i zhvillimit ekonomik të zonës në tërësi

**Objektivi :** Transformimi i Korçës në një destinacion turistik me shumë përmasa atraktive sezonale përgjatë gjithë vitit – i) kulturore, ii) natyrore (eko-turizëm), iii) të shijes, etj.

Për përmbushjen e këtij objektivi është parashikuar programi i zhvillimit të Turizmit.

**Objektivi :** Shërbime publike të standardeve të larta për një jetë më cilësore të banorëve të Korçës për përmbushjen e këtij objektivi është parashikuar programi Shërbimeve Publike Vendore.

## Projektet kryesore të PBA-së 2020-2022

### Paraqitja e projekteve kryesore–arsyet dhe përfituesit

Burimi i informacionit: Fishat e projekteve të PPV/PZhS

### Plani i shpenzimeve kapitale /projekt plani 2020-2022

Marrë nga Instrumenti i Planifikimit Financiar, [F15]

<b>(F15) SHPENZIMET KAPITALE SIPAS PROGRAMEVE</b>							
		2017	2018	2019	2020	2021	2022
<b>Nënfunkcioni 1</b>	<b>011 Organet ekzekutive dhe legislative, për çështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme</b>	<b>894</b>	<b>4,048</b>	<b>5,345</b>	<b>3,300</b>	<b>3,500</b>	<b>3,700</b>
01110	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	894	4,048	4,391	2,300	2,500	2,700
01120	Çështje financiare dhe fiskale	-	-	954	1,000	1,000	1,000
01170	Gjendja civile	-	-	-	-	-	-
<b>Nënfunkcioni 2</b>	<b>017 Shërbime të huamarrjes vendore</b>	-	-	-	-	-	-
01710	Pagesa për shërbimin e borxhit të brendshëm	-	-	-	-	-	-
<b>Nënfunkcioni 3</b>	<b>031 Shërbimet Policore</b>	-	-	-	-	-	-
03140	Shërbimet e Policisë Vendore	-	-	-	-	-	-
<b>Nënfunkcioni 4</b>	<b>032 Shërbimet e mbrojtjes ndaj zjarrit</b>	<b>93</b>	<b>271</b>	<b>17,358</b>	<b>2,200</b>	<b>2,200</b>	<b>2,550</b>
03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	93	271	17,358	2,200	2,200	2,550
<b>Nënfunkcioni 5</b>	<b>036 Marrdheniet me komunitetin</b>	-	-	-	-	-	-
03600	Marrdheniet me komunitetin	-	-	-	-	-	-
<b>Nënfunkcioni 6</b>	<b>041 Çështjet e përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës</b>	-	-	<b>2,090</b>	-	-	-
04130	Mbështetje për zhvillimin ekonomik	-	-	2,090	-	-	-
04160	Shërbimet e tregjeve, akreditimi dhe inspektimi	-	-	-	-	-	-
<b>Nënfunkcioni 7</b>	<b>042 Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia</b>	<b>92,307</b>	<b>50,189</b>	<b>153,515</b>	<b>29,624</b>	<b>30,217</b>	<b>30,519</b>
04220	Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatoreve	-	-	-	-	-	-
04240	Menaxhimi i Infrastruktues së ujitjes dhe kullimit	67,018	49,615	60,416	-	-	-
04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	25,289	574	93,099	29,624	30,217	30,519
<b>Nënfunkcioni 8</b>	<b>045 Trasporti</b>	-	<b>106,873</b>	<b>170,814</b>	<b>215,509</b>	<b>301,726</b>	<b>341,346</b>
04520	Rrjeti rrugor rural	-	106,873	170,814	215,509	301,726	341,346
04570	Transporti publik	-	-	-	-	-	-
<b>Nënfunkcioni 9</b>	<b>047 Industri të tjera</b>	-	-	<b>3,153</b>	-	-	-

04740	Projekte Zhvillimi	-	-	-	-	-	-
04760	Zhvillimi i turizmit	-	-	3,153	-	-	-
<b>Nënfunksioni 10</b>	<b>051 Menaxhimi i i mbetjeve</b>	-	-	-	-	-	-
05100	Menaxhimi i mbetjeve	-	-	-	-	-	-
<b>Nënfunksioni 11</b>	<b>052 Menaxhimi i ujrave të zeza</b>	-	-	-	-	-	-
05200	Menaxhimi i ujrave të zeza dhe kanalizimeve	-	-	-	-	-	-
<b>Nënfunksioni 12</b>	<b>053 Reduktimi i ndotjes</b>	-	-	-	-	-	-
05320	Programet e mbrojtjes së mjedisit	-	-	-	-	-	-
<b>Nënfunksioni 13</b>	<b>056 Mbrojtja e mjedisit</b>	-	-	-	-	-	-
05630	Ndërgjegjësimi mjedisor	-	-	-	-	-	-
<b>Nënfunksioni 14</b>	<b>061 Urbanistika</b>	<b>1,320,290</b>	<b>433,425</b>	<b>92,096</b>	<b>55,000</b>	<b>12,000</b>	<b>12,000</b>
06140	Planifikimi Urban Vendor	1,320,290	433,425	92,096	55,000	12,000	12,000
<b>Nënfunksioni 15</b>	<b>062 Zhvillimi i komunitetit</b>	<b>29,754</b>	<b>36,284</b>	<b>43,789</b>	<b>27,000</b>	<b>27,540</b>	<b>27,815</b>
06210	Programet e zhvillimit	-	-	-	-	-	-
06260	Sherbime publike vendore	29,754	36,284	43,789	27,000	27,540	27,815
<b>Nënfunksioni 16</b>	<b>063 Furnizimi me ujë</b>	-	-	-	-	-	-
06330	Furnizimi me ujë	-	-	-	-	-	-
<b>Nënfunksioni 17</b>	<b>064 Ndriçimi i rrugëve</b>	-	-	<b>3,774</b>	<b>2,700</b>	<b>2,700</b>	<b>2,700</b>
06440	Ndriçim rrugësh	-	-	3,774	2,700	2,700	2,700
<b>Nënfunksioni 18</b>	<b>072 Shërbimet e kujdesit parësor</b>	-	-	-	-	-	-
07220	Shërbimet e kujdesit parësor	-	-	-	-	-	-
<b>Nënfunksioni 19</b>	<b>081 Shërbimet rekreative dhe sportive</b>	-	<b>119</b>	<b>9,255</b>	-	-	-
08130	Sport dhe argëtim	-	119	9,255	-	-	-
<b>Nënfunksioni 20</b>	<b>082 Shërbimet kulturore</b>	<b>82,222</b>	<b>75,672</b>	<b>114,811</b>	<b>1,100</b>	<b>1,200</b>	<b>1,500</b>
08220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	82,222	75,672	114,811	1,100	1,200	1,500
<b>Nënfunksioni 21</b>	<b>091 Arsimi bazë dhe parashkollor</b>	<b>7,393</b>	<b>4,378</b>	<b>81,609</b>	<b>7,100</b>	<b>7,100</b>	<b>7,100</b>
09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor.	7,393	4,378	81,609	7,100	7,100	7,100
<b>Nënfunksioni 22</b>	<b>092 Arsimi parauniversitar</b>	<b>33,682</b>	<b>1,466</b>	<b>1,235</b>	<b>50,200</b>	<b>50,200</b>	<b>50,250</b>
09230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	33,682	1,466	150	50,200	50,200	50,250
09240	Arsimi profesional	-	-	-	-	-	-

		-	-	1,085	-	-	-
<b>Nënfunkcioni 23</b>	<b>101 Sëmundje dhe paaftësi</b>	<b>331</b>	-	-	-	-	-
10140	Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara	331	-	-	-	-	-
<b>Nënfunkcioni 24</b>	<b>102 Të moshuarit</b>	-	-	-	-	-	-
10220	Sigurimi shoqëror	-	-	-	-	-	-
<b>Nënfunkcioni 25</b>	<b>104 Familje dhe fëmijë</b>	-	-	<b>441</b>	-	-	-
10430	Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	-	-	441	-	-	-
<b>Nënfunkcioni 26</b>	<b>105 Papunësia</b>	-	-	-	-	-	-
10550	Papunësia, arsim dhe aftësim	-	-	-	-	-	-
<b>Nënfunkcioni 27</b>	<b>106 Strehimi social</b>	<b>2,560</b>	<b>354</b>	<b>8,658</b>	-	-	-
10661	Strehimi social	2,560	354	8,658	-	-	-
<b>Totali</b>		<b>1,569,526</b>	<b>713,079</b>	<b>707,943</b>	<b>393,733</b>	<b>438,383</b>	<b>479,480</b>

### 3. Informacion financiar

#### Supozimet e planifikimit

Tabela D2

#### (D2) LLOGARITJET MAKROEKONOMIKE

	2017	2018	2019	2020	2021	2022
	Viti t-2	Viti i shkuar	Vitit aktual (I pritur)	Viti t+1 (I pritur)	Viti t+2 (I pritur)	Viti t+3 (I pritur)
<b>Norma e inflacionit</b>	2.00%	2.10%	2.70%	3.00%	3.00%	3.00%
<b>Norma reale e rritjes ekonomike</b>	3.80%	4.20%	4.30%	4.40%	4.50%	4.50%
<b>Norma e rritjes së pagave (nominale)</b>	4.00%	3.90%	3.70%	3.60%	3.50%	3.50%
<b>Norma e Interesit (3 mujor)</b>			0.89%	0.89%	0.89%	0.89%
<b>Norma e Interesit (5 vjeçar)</b>			4.50%	4.50%	4.50%	4.50%
<b>Kursi i këmbimit (në fund të vitit) shuma në LEK për 1 EURO</b>	134.20	127.60	127.60	127.60	127.60	127.60

## **Burimi i të ardhurave**

*Tabela F1: Analizë për parashikimin e të ardhurave për periudhën 2020-2022 (Faktorët e rritjes ose uljes së nivelit të mbledhjes së taksave/tarifave)*

Buxheti për tre vitet e ardhshme ka në qendër, rritjen e të ardhurave, rritjen e shërbimeve, rritjen e aksesit dhe të cilësisë së jetës nga qyteti deri në skajet më të largëta të Bashkisë Korçë.

Vizioni ynë është që të krijojmë një sistem që nxit transparencën, llogaridhënien, disiplinën fiskale dhe efikasitetin në mbledhjen, administrimin dhe përdorimin e burimeve financiare për shërbime më të mira dhe zhvillim të mëtejshëm ekonomik. Parashikimi i buxhetit afatmesëm për Bashkinë Korçë në tre vitet e ardhshme është i mbështetur kryesisht në llogaritjet e kapaciteteve të taksave e tarifave, në ecurinë e realizimit të tyre në vite, si dhe politikat e përcaktuara për vitet pasardhëse, duke u mbështetur në legjislacionin aktual në fuqi.

Këto parashikime mbështeten në llogaritjet e përgjithshme që janë të lidhura ngushtë me masat që pritet të ndërmerren nga administrata tatimore në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Bashkisë, por dhe jashtë saj, për realizimin e parashikimeve të pretenduara të të ardhurave.

Parashikimi i të ardhurave për periudhën afatmesme parashikon rritjen e nivelit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, duke forcuar kapacitetet administruese, duke zgjeruar bazën e taksapaguesve, si dhe duke marrë në konsideratë :

- a) Përpjekjet për të forcuar menaxhimin e të ardhurave, për të rritur efikasitetin e tyre në mbledhjen e të ardhurave, zvogëluar hendekun tatimor, luftuar evazionin fiskal dhe ekonominë informale.
- b) Lehtësimi i procedurave në marrëdhënie me subjektet dhe familjarët.
- c) Ecurinë e realizimit të të ardhurave për faktorët që kanë ndikuar në rritjen ose pakësimin e arkëtimeve

Gjatë viteve të kaluara, paketave fiskale respektive u janë bërë ndryshime thelbësore të cilat kanë pasur në fokus të lehtësojnë edhe më shumë barrën për biznesin siç janë:

1. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, ka lehtësuar kështu biznesin e vogël dhe sidomos të vetëpunësuarit. Kështu, biznesi me qarkullim vjetor nga 0 deri në 5 milionë lekë nuk paguan më këtë tatim, ndërsa biznesi me qarkullim vjetor nga 5 deri në 8 milionë lekë paguan 5% të fitimit të tatueshëm.
2. Taksa e ndërtesës e cila ndryshoi shkallën e taksës, ku nga taksim me vlerë fikse për m<sup>2</sup> kaloi në taksim me vlerë tregu, duke lehtësuar me gati 52% ngarkesën fiskale.
3. Taksa e tabelës për qëllime identifikimi e cila ndryshoi nivel për çdo kategorizim, duke bërë dallimin midis llojshmërisë së tabelave, e cila shkoi deri në përgjysmimin e kësaj takse.
4. Përgjysmimi i tarifës për servitutin e kalimit në prona publike.



5. Përrjashtimi nga detyrimi për të paguar tarifën me tavolina jashtë lokalit për të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitet me tavolina jashtë lokalit në pronë publike.

6. Përrjashtimi nga detyrimi për të paguar tarifën vendore (tarifë pastrimi, tarifë ndriçimi dhe tarifë gjelbërimi) të gjitha bizneset e reja që do të hapin dhe regjistrojnë për herë të parë aktivitet në Pazarin e Vjetër të qytetit dhe në Inkubatorin e Biznesit tek ish UMB, për një periudhë 1 vjeçare nga krijimi i tyre.

7. Heqja e taksës së përrkohshme për linjat ajrore dhe nëntokësore (telefoni, energji, tv kabllor,internet) taksë kjo që aplikohej në të gjitha subjektet që operonin në këtë fushë.

Të gjitha sa përrmendem më sipër por dhe jo vetëm këto, kanë pasur në fokus sikurse dhe e kemi përrmendum më sipër të lehtësojnë edhe më shumë barrën për biznesin, të ndikojnë në rritjen e të ardhurave në buxhetet familjare, duke rritur ekonominë në ato familje dhe jo vetëm.

(F1) BURIMET BUXHETORE								
			2017	2018	2019	2020	2021	2022
			Viti t-2	Viti i shkuar	Viti aktual	Viti aktual	Viti t+1 (I pritur)	Viti t+2 (I pritur)
<b>A</b>	<b>TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA</b>		578,864	642,297	1,087,137	1,068,400	1,089,722	1,100,541
<b>A.1</b>	<b>TË ARDHURA NGA TAKSAT LOKALE</b>		240,626	240,010	531,813	537,131	547,874	553,352
<b>A.1.1</b>	<b>Taksa vendore mbi biznesin e vogël</b>		6,728	5,191	23,000	23,230	23,695	23,932
<b>A.1.2</b>	<b>Taksa mbi pasurinë e paluajtshme</b>		130,129	134,737	207,410	209,484	213,674	215,811
A.1.2.1	Taksa mbi ndërtesën		103,193	102,953	149,569	151,065	154,086	155,627
A.1.2.2	Taksa mbi tokën bujqësore		20,816	22,657	48,841	49,329	50,316	50,819
A.1.2.3	Taksa mbi truallin		6,120	9,127	9,000	9,090	9,272	9,365
A.1.2.4	Taksa mbi transaksionet e pasurisë		-	-	-	0	0	0
<b>A.1.3</b>	<b>Taksa vendore në shërbimin hotelier</b>		3,931	5,060	5,500	5,555	5,666	5,723
<b>A.1.4</b>	<b>Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja</b>		86,475	59,464	240,000	242,400	247,248	249,720
<b>A.1.5</b>	<b>Taksa e tabelës</b>		13,362	9,552	15,903	16,062	16,383	16,547
<b>A.1.6</b>	<b>Taksa vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testament dhe llotaritë vendore</b>		-	26,006	40,000	40,400	41,208	41,620
<b>A.1.7</b>	<b>Taksa e përrkohëshme</b>	aaa	1	-	-	0	0	0
<b>A.1.8</b>	<b>Taksa e përrkohëshme 1</b>	bbb	-	-	-	0	0	0
<b>A.1.9</b>	<b>Taksa e përrkohëshme 2</b>	ccc	-	-	-	0	0	0

<b>A.2</b>	<b>TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA (GRANTE)</b>	<b>37,969</b>	<b>57,148</b>	<b>81,800</b>	<b>82,618</b>	<b>84,270</b>	<b>85,113</b>
A.2.1	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë / pasuritë e paluajtshme	7,390	9,591	13,000	13,130	13,393	13,527
A.2.2	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	24,619	37,623	42,000	42,420	43,268	43,701
A.2.3	Taksa e rentës minerare	74	110	200	202	206	208
A.2.4	Taksa mbi të ardhurat personale	-	-	-	0	0	0
A.2.5	Taksa të tjera	5,886	9,824	26,600	26,866	27,403	27,677
<b>A.3</b>	<b>TË ARDHURA NGA TARIFA VENDORE</b>	<b>279,222</b>	<b>318,017</b>	<b>415,111</b>	<b>419,262</b>	<b>427,648</b>	<b>431,925</b>
<b>A.3.1</b>	<b>Tarifa me menaxhimit te mbetjeve</b>	<b>112,670</b>	<b>155,983</b>	<b>183,510</b>	<b>185,345</b>	<b>189,052</b>	<b>190,943</b>
A.3.1.1	Tarifa e pastrimit për familjet	47,529	74,167	116,138	117,299	119,645	120,842
A.3.1.2	Tarifa e pastrimit për institucionet	1,953	2,426	-	0	0	0
A.3.1.3	Tarifa e pastrimit për biznesin	63,188	79,390	67,372	68,046	69,407	70,101
<b>A.3.2</b>	<b>Tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>A.3.3</b>	<b>Tarifa për ndriçimin publik</b>	<b>36,267</b>	<b>37,943</b>	<b>44,424</b>	<b>44,868</b>	<b>45,766</b>	<b>46,223</b>
A.3.3.1	Tarifa për ndriçimin publik nga familjet	16,882	18,220	26,695	26,962	27,501	27,776
A.3.3.2	Tarifa për ndriçimin publik nga institucionet	439	422	-	0	0	0
A.3.3.3	Tarifa për ndriçimin publik nga biznesi	18,946	19,301	17,729	17,906	18,264	18,447
<b>A.3.4</b>	<b>Tarifa për gjelbërimin</b>	<b>23,683</b>	<b>24,707</b>	<b>31,717</b>	<b>32,034</b>	<b>32,675</b>	<b>33,002</b>
A.3.4.1	Tarifa për gjelbërimin nga familjet	9,732	10,006	18,132	18,313	18,680	18,866
